



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. dhe 1.5., nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtoi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, më datën 07.07.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-810/23, për zyrtarin e lartë z. Hekuran Nikçi, Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për zyrtarin e lartë publik z. Hekuran Nikçi, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Rasti ka filluar të trajtohet pas pranimit të kërkesës nga jashtë (DPKI-06-810/23) për sqarim nëse ekziston situata e konfliktit të interesit në rastin e z. Hekuran Nikçi, i cili në cilësinë e Kryeinspektorit ka shfuqizuar gjobat e shqiptuara nga Inspektorati i Punës ndaj ish-kolegëve të tij me të cilët ka punuar paraprakisht në NP "Trepça", e gjithashtu z. Nikçi ka nxjerrë një vendim lidhur me KRU "Prishtina", në të cilën ndërmarrje i njëjti e ka të ngrirë pozitën e auditorit të brendshëm.

Lidhur me këtë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit (DPKI-06-02-924/23).

Me qëllim të trajtimit dhe sqarimit të gjithanshëm të rastit, Agjencia ka kërkuar dokumentacion plotësues nga institucioni përkatës dhe në përgjigje të këtyre kërkesave, ka pranuar dokumentacionet e kërkuar (DPKI-06-1151/23; DPKI-06-1276/23; DPKI-06-1305/23), sipas të cilave është gjetur se:

Komisioni i Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës, në përbërje të z. Hekuran Nikçi kryetar, z. M.V. anëtar, duke vendosur sipas Ankesës së palëve në procedurë S.H, B.H, SH.K., dhe SH.S., (anëtar të Bordit të Drejtorëve "Trepça" SH.A.) më datën 26.10.2022 ka nxjerrë Vendimin IP Nr.prot. 719 datë 04.11.2022, përmes të cilit është aprovuar ankesa e palëve në procedurë dhe është anuluar Vendimi nr.02.Nr.22-98/2020C i Inspektoratit të Punës-

shkalla e parë, me të cilin në rishqyrtim palëve në procedurë u ishte shqiptuar masë ndëshkimore me gjoba.

Gjithashtu, Komisioni i Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës, në përbërje të z. Hekuran Nikçi kryetar, z. M.V. anëtar, dhe A.D. anëtar, duke vendosur sipas Ankesës së palës në procedurë E.A., (UD. Kryeshef Ekzekutiv i NP “Trepça”) më datën 15.02.2023 ka nxjerrë Vendimin IP Nr.prot. 88 datë 02.03.2023, përmes të cilit është miratuar si e bazuar Ankesa e palës në procedurë dhe është shfuqizuar Vendimi Nr.17-80/2022B, datë 05.07.2022 i Inspektoratit të Punës-shkalla e parë, me të cilin palës në procedurë i ishte shqiptuar masa ndëshkimore me gjobë.

Edhe në rastin lidhur me KRU “Prishtina”, Komisioni i Organit të Shkallës së Dytë të Inspektoratit të Punës në përbërje të z. Hekuran Nikçi kryetar, z. M.V. anëtar, N.F. anëtar, duke vendosur sipas Ankesës së subjektit në procedurë KRU “Prishtina” SH.A., të ushtruar kundër Vendimit të Organit të shkallës së parë të Inspektoratit të punës, më datën 09.11.2022 ka nxjerrë Vendimin IP Nr.prot. 779, përmes të cilit është refuzuar si e pabazuar ankesa subjektit juridik në procedurë KRU “Prishtina” dhe është vërtetuar Vendimi nr.01.Nr.12-131/98 datë 22.04.2022 i Inspektoratit të Punës-shkalla e parë, me të cilin i ishte aprovuar si e bazuar ankesa e palës Q.K. (zyrtare e KRU “Prishtina”).

Sipas Aktvendimit Nr. 3514/24 i datës 23.01.2015 të KRU “Prishtina”, z. Nikçi është në marrëdhënie pune me kompaninë në fjalë - pozita Auditori i Brendshëm, e të cilën pozitë sipas Vendimit Nr.3321 i datës 08.12.2022 të KRU “Prishtina”, z. Nikçi e ka pezulluar përkohësisht dhe atë me rastin e emërimit të tij në pozitën e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant dhe informatave të siguruar nga institucionet relevante, Agjencia nuk ka gjetur se ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për konflikt të interesit në frymën e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, kjo për faktin se:

Konflikti i interesit është i lidhur me vendimmarrjen e personit zyrtar për interes privat apo për interes të personit të afërm, ashtu siç është përcaktuar me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, sipas të cilit “Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.”(neni 6), lidhur me “vendimmarrjen” e cila sipas nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.12, përcaktohet si çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.

Andaj, referuar dispozitave ligjore të lartcekura, në rastin konkret nuk është gjetur që z. Nikçi, të ketë pasur interes privat për vete apo personat e afërm me rastin e pjesëmarrjes dhe nënshkrimit të vendimeve si më lartë.

Dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive ligjore

dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit
